



A.nr.2034/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.2034/2025, të datës 16.12.2025, të parashtruar nga ankuesit K.Z, L.M, M.D-H, S.A-B, F.S.B. dhe A.O, të përfaqësuar nga ankuesi K.Z, si përfaqësues i përbashkët, kundër organit të punësimit: Thesarit të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.2034/2025, e datës 16.12.2025, e parashtruar nga ankuesit K.Z, L.M, M.D-H, S.A-B, F.S-B dhe A.O.

A r s y e t i m

Ankuesit K.Z, L.M, M.D-H, S.A-B, F.S-B dhe A.O. (*tutje referuar vetëm ankuesit*, më datë 16.12.2025, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të kategorizimit gabimisht në kategorinë profesionale, klasa profesional 1 e jo sipas kategorisë së ulët drejtuese.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Thesari i Kosovës, ndërsa, ky i fundit ka përcjellë përgjigje në ankesë.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesit, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton:

-Ankuesit janë të punësuar në Thesarin e Kosovës, dhe së ankuesi K.Z, sipas Akt Emërimit të datës 29.03.2012, mbanë pozitën *Menaxher i Njesisë Llogaritare-Financiare*; ankuesja L.M, sipas Akt Emërimit të datës 19.12.2016, mbanë pozitën *Zyrtare e Lartë e Ekzekutivit*; ankuesja M.H, sipas Akt Emërimit të datës 29.03.2012, mbanë pozitën *Menaxhere e Njesisë së Alokimeve*, ankuesja S.A-B, sipas Akt Emërimit të datës 29.03.2012, mbanë pozitën *Menaxhere e Grandeve*; ankuesja F.B, sipas Akt Emërimit të datës 01.12.2014,

mbanë pozitën *Menaxhere e të Hyrave*; dhe ankuesja A.O, sipas Akt Emërimit të datë 06.01.2014, mbanë pozitën *Zyrtare e Tavolinës Ndihmës*.

-Ankuesit më datë 14.11.2025, kanë parashtruar kërkesë tek zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, për kategorizimin e pozitave të tyre si pozita menaxheriale.

-Menaxherja e Personelit në Thesarin e Kosovës, më datë 19.11.2025, në përgjigje të kërkesës së ankuesve, ka njoftuar këta të fundit me sqarimin citojmë: *se fusha e veprimtarisë dhe përgjegjësi të Thesarit është e klasifikuar në katër fusha kryesore ku secila prej tyre përbëhet nga dy ose tri divizione të udhëhequra nga Udhëheqës të Divizioneve, dhe bazuar në akt emërimit dhe përshkrimin e detyrave të punës së pozitës suaj koeficienti ka qenë 8, dhe pozita Menaxher i Fushës është e ekuivalentuar në klasën profesional 1 nga DMZP, andaj, duke qenë se jemi në pritje të aprovimit të rregullores së re, atëherë Thesari do të jetë i obliguar të përfundoj ristrukturimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në harmoni me legjislacionin përkatës në fuqi, kështu që Zyra e Burimeve Njerëzore nuk ka bazë ligjore që pozitën e juaja të klasifikohen si drejtues i ulët deri në përfundimin e procesit të ristrukturimit të vendeve të punës.*

Pretendimet ankimore

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendojnë se janë kategorizuar gabimisht në kategorinë profesional 1. Shtojnë së sipas akt emërimeve janë shefa të njësisë të barasvlershme me kategorinë drejtues i ulët, andaj, duke mbajtur pozitë me përgjegjësi menaxheriale nuk jemi kategorizuar si të tillë. Kërkojnë që Këshilli të aprovoj ankesën dhe të detyroj institucionin që pozita e tyre të kategorizohet si drejtues i ulët.

Vlerësimi i Kolegjit

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit iu referua Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me theks të veçantë nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenin 14 paragrafi 3 ku parashihet se: **"Neni 2:** 1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", **Nenin 14:** 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik..." , referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar sipas shtojcave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Në fakt, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Thesari i Kosovës deri në parashtrimin e ankesës nga ana e ankueses nuk ka të përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, mirëpo, në përgjigjen në ankesë të datës 30.12.2025 si dhe shkresave tjera të çështjes del së Thesari i Kosovës ka ndërmarr veprime në kuptim të nxjerrjes së Rregullores për organizim të brendshëm dhe klasifikim të vendeve të punës në këtë

institucion, gjegjësisht, përmes përgjigjes në ankesë të datës 30.12.2025, Thesari i Kosovës është në procesin e hartimit dhe miratimit të rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Andaj, mbi këtë rrethanë faktike dhe duke qenë se procedimi i pozitës së ankuesve në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tyre të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht, Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës (lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë) dhe duke qenë se institucioni punëdhënës është në fazën e miratimit të rregullores lidhur me klasifikimin e vendeve të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, atëherë, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtuar nga ankuesit për klasifikimin e pozitës së tyre sipas kategorisë drejtues i ulët, është e parakohshme, e për rrjedhojë, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kuptim të parimit të ligjshmërisë dhe pritshmërisë legjitime si parime bazë në punën e institucioneve publike, Kolegji i Këshillit rikujton organin punëdhënës në këtë rast Thesarin e Kosovës që bazuar në nenin 34 të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e aplikueshme nga data 28.02.2024, si dhe në mbështetje të Vendimit Nr.08/226, të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, **ka qenë e obliguar që të përfundoj klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe këtë katalog.** Andaj, çdo shmangie nga ky detyrim ligjor përbën mos veprim të organit publik dhe njëkohësisht bartë pasojë për zyrtarët publikë në kuptim të klasifikimit të pozitës dhe pagës së tyre, kështu që, Thesari i Kosovës duhet të përfundoj sa më shpejt rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizimin vendeve të punës, në atë mënyrë që nëpunësit të realizojnë pagën në pajtim me legjislacionin aplikueshëm.

Thënë si më lartë, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS A.nr.2034/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të përbashkët të ankuesve K.Z;
- Thesarit të Kosovës: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së.